

[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

Nr.9932, datë 9.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8977, DATË 12.12.2002 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,
KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 11 "Kundërvajtjet administrative" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për taksat kombëtare, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Neni 12 "Dënimet" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

Sanksionet

Dënimet administrative për kundërvajtjet në taksat kombëtare përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5788, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2015 - www.ligjet.org